

LIGJ
Nr.10 493, datë 15.12.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9741, DATË 21.5.2007 “PËR ARSIMIN
E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 6 bëhet ky ndryshim:

Pas fjalëve “së paku, gradën shkencore “Doktor” dhe përvojë pune” shtohen fjalët “klinike dhe akademike”.

2. Në pikën 6/2, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur në një lëndë/disiplinë ka më shumë se një shërbim, Bordi i Qendrës Spitalore Universitare për zgjedh një nga përgjegjësit e shërbimit me përvojën më të gjatë kliniko-akademike për titullar të njësisë bazë të fakultetit dhe ia paraqet për emërim rektorit të institucionit të arsimit të lartë. Ai është përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë mësimore-kërkimore në fushën përkatëse. Mandati i tij është i njëjtë me atë të përgjegjësit të shërbimit.”.

Neni 2

Në nenin 23 pika 1 bëhet ky ndryshim:

Fjala e dytë riformulohet si më poshtë:

“Autoritetet drejtuese nuk mund të zgjidhen për më shumë se dy mandate radhazi në të njëjtin funksion.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7214, datë 23.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi